

V E N D I M
Nr. 34, datë 26.3.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	nëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

Me sekretare Arta Palushi, më datë 28.9.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.44/1 Akti që i përket:

K Ë R K U E S E: ZANA PANGO, e përfaqësuar nga avokat Kleanth Koçi.

SUBJEKT I INTERESUAR: AUREL SELMANI, i përfaqësuar nga avokat Spiro Peçi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues të vendimeve nr.513, datë 17.4.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr.20, datë 27.2.1998 të Gjykatës së Apelit.

Kërkuesja ka paraqitur si shkaqe ligjore për shpalljen antikushtetues të vendimeve të mësipërme shkeljen e nenit 38 të Ligjit për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut” dhe konkretisht:

- Akteve gjyqësore u mungon procesverbali i seancës gjyqësore;
- Gjykata e Apelit, nuk ka pranuar kërkesën tonë për gjykimin e çështjes nga e para;
- Gjykata e Kasacionit nuk e ka shqyrtuar çështjen në seancë të rregullt gjyqësore, por në Dhomën e Këshillimit, megjithëse i kishim parashtruar disa shkaqe ligjore, për të cilat nuk ka dhënë përgjigje;
- Vendimi i Gjykatës së Kasacionit, ka cënuar të drejtën tonë të garantuar nga neni 38 i Ligjit për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi përfaqësuesit e kërkueses dhe të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.8432, datë 14.12.1998 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, individëve të cilët kanë pretendim për shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese për një proces gjyqësor të rregullt, ju lind e drejta të përdorin rekursin ndaj vendimeve të formës së prerë të gjykatave si një mjet i ri juridik, pranë Gjykatës së Lartë.

Lidhur me kuptimin e drejtë të dispozitave të këtij ligji, zbatohet parimi i njohur i së drejtës procedurale sipas të cilit ligji i ri ka fuqi edhe për marrëdhëniet procedurale të lindura para hyrjes së tij në fuqi, për çështjet që gjenden në hetim dhe gjykim, me përjashtim të rasteve dhe për sa kohë që ligji shprehimisht ka vendosur. Ky parim gjen konkretizim në Kodin e Procedurës Civile si dhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese. Një shqyrtim analitik i dispozitave që përmban Kreu i XVIII-të, Dispozita Kalimtare dhe të Fundit të Kushtetutës, të çon në përfundimin se edhe në këtë akt themelor, lidhur me zbatimin në kohë ndiqet i njëjti parim.

Ligji i ri procedural e gjeti procesin gjyqësor të papërfunduar e për rrjedhojë Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, ka ndalim kushtetues të vendosë përfundimisht përsa kohë që për kërkuesin potencialisht ekziston edhe një mjet juridik – rekursi para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nëse pas konsumimit të këtij mjeti juridik kërkuesi do të ketë pretendime për shkelje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, mund t’i drejtohet me kërkesë të re Gjykatës Kushtetuese. Të pranohet e kundërta, dmth., Gjykata Kushtetuese në këtë

situatë juridike të zgjidhë përfundimisht çështjen, do të thotë të preken të drejtat e subjekteve në proces, të cilëve ligji u njeh një mjet të ri, para se problemi të referohet si objekt i kontrollit kushtetues. Nga ana tjetër, kjo do të krijonte diferencime të papërligjura në trajtimin e kërkesave të ndryshme, të cilat ligji i ri i gjeti në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE ;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 132 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës për mungesë juridiksioni.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimi nr.34, datë 26.3.1999 të Gjykatës Kushtetuese.

Pa dashur për të diskutuar gjatë arsyet e quaj të mjaftueshme të theksoj se vendimi i votuar nga kjo Gjykatë para hyrjes në fuqi të Ligjit nr.8432, datë 14.12.1998 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, pavarësisht se kur shpallet, duhet të publikohet detyrimisht ashtu siç është votuar.

Duke ndryshuar atë, qoftë dhe për shkaqet e pranuar në vendim, mendoj se shumica ka gabuar.

K R Y E T A R I
F.Abdju

Tiranë, më 26.3.1999

Nr. 44/1 i regjistrimit themeltar
Nr. 34 i vendimit.